



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA ARSIMIT KULTURES TURIZMIT RINISE DHR SPORTIT

Nr. 4344 Prot.

Rrogozhinë, më 09.10.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. ___ /, Datë ___ / ___ / ____.

“PËR DOKUMENTACIONIN DHE KRITERET E KËRKUARA PËR PËRFITIMIN E BURSIVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”

Në zbatim të Vkm Nr.666, datë 10.10.20219 “Për kuotat finaciare të ushqimit në mensa e konvikte dhe për përcaktimin e kriterëve për përcaktimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, Neni 28, pika 4, shkronja a,b,c,ç,d të ligjit Nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

PROPOZOJM

Të miratohen listat e dokumentacionit dhe kriterëve për përfitimin e bursave në Arsimin Parauniversitar si më poshtë vijon:

Nr	Kriteret për përfitimin e bursës
1	Kriteri Ekonomik
a)	Vërtetim banimi që përcakton largësin banesë -shkollë(Mbi 5 Km)
2	Kriteri rezultateve të arritura
a)	Vërtetim notash(Mesatarja 9-10)
3	Kriteri jo ekonomik
a)	Nxënësi që ka statusin e jetimit
b)	Nxënësi që ka humbur kujdestarin prindëror
c)	Nxënës me status ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik
d)	Nxënës me status ligjor që nuk dëgjojnë dhe nuk shikoj.
e)	Nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit.(Njërin apo të dy prindërit)
ë)	Nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane që ndjekin arsimin profesional.
f)	Nxënësit, e identifikuar dhe trajtuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror



g)	Nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës
h)	Nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë;
i)	Nxënësit me një prind.
4	Kriteri degëve parësore
a)	Nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional në drejtimet mësimore bujqësi, veterinar, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit

Sqarim:Për të përfutuar bursë nxënësi duhet të plotësojë të paktën 1(nji) nga kriteret e sipërpërmendura.

Asnjë kategori e sipërpërmendur nuk përfiton bursë në rast se:

- Janë ndarë nga trangu familjar;
- Familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
- Deklarohen mbetës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluese.

Dokumentacioni i kërkuar për të gjitha kategoritë:

- Kërkesë për bursë studimi.
 - Vërtetim regjistrimi në shkollën ku ndjek studimet.
 - Fotokopje dëftësës të klasës që ka mbaruar.
 - Çertifikatë personale ose fotokopje Id/Pashaportë.
 - Vërtetim që ka shlyer detyrimet vendore.
 - Vërtetim që nuk ushtron aktivitet privat.
 - Vërtetim për të paktën një nga kriteret e sipërpërmendura.
 - Numër llogarie bankare(Të prindit/Kujdestarit) pranë bankave të nivelit të dytë.
- Ngarkohet për zbatim Drejtoria Arsimit,Kulturës,Turizmit,Rinisë dhe Sporteve.

Drejtor AKTRS
Orges TOSKU

Kryetar
Edison MEMOLLA

Në mungesë dhe me urdhër
Nënkryetar
Andi PROSHKA

Adresa: BashkiaRrogozhinë, Lagja Nr. 1, Rruga e Kavajës, Blloku "12 Shtatori"

Tel.fax: 0577 220-31



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
DREJTORIA ARSIMIT KULTURËS TURIZMIT RINISË DHR SPORTIT

Nr. 4/344 Prot.
11

Rrogozhinë, më 08.10.2025

RELACION SHPJEGUES
“PËR DOKUMENTACIONIN DHE KRITERET E KËRKUARA PËR PËRFITIMIN E
BURSAVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”

Projektvendimi “Për dokumentacionin dhe kriteret e kërkuara për përfitimin e bursave në arsimin parauniversitar” vjen si ç’do fillim te ri viti shkollorë për të përcaktuar dokumentacionin dhe kriteret për përfitimin e bursave në arsimin parauniversitar qoftë të përgjithshëm apo professional por edhe në zbatim të Vkm Nr.666, datë 10.10.20219 “Për kuotat finaciare të ushqimit në mensa e konvikte dhe për përcaktimin e kriterëve për përcaktimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, Neni 28, pika 4, shkronja a,b,c,ç,d të ligjit Nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar

Si ç’do fillim të ri të vitit shkollorë ministritë e linjës, në këtë rast Ministria e Arsimit për arsimin parauniversitar të përgjithshëm dhe Ministria Ekonomisë dhe Inovacionit për arsimin profesional në konsultim me institucionet arsimore hartojnë planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar të përgjithshëm dhe professional, të cilin e dërgojn pranë institucionit tonë jo më vonë se muaji tetor, duke përcaktuar edhe numrin e kuotave që na kanë përcaktuar.

Drejtorja Arsimit Kulturës Turizmit Rinisë dhe Sporteve bazuar në planin e përcaktuar nga Ministritë e linjës, me vendim të Këshillit Baskiak jo më vonë se muaj Dhjetor miraton dhënien e bursave.



Drejtoria Arsimit Kulturës Turizmit Rinisë dhe Sporteve u dërgon zyrtarisht, jo më vonë se muaji dhjetor i çdo viti, i shpërndan drejtorive të shkollave të arsimit profesional dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitar vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Drejtor Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve

Orges TOSKU